



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
DREJTORIA EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 3400 prot.

Tiranë, më 31.12 2024

U R D H Ë R

Nr. 119 datë 31/12 2024

“PËR

**NGRITJEN E NJËSISË PËRGJEGJËSE PËR SINJALIZIMIN DHE MBROJTJEN
E SINJALIZUESVE NË ZYRËN E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË”**

Në mbështetje të nenit 147/d të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, të ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, i ndryshuar, të pikës 3 dhe të pikës 11, të Vendimit nr. 816, datë 16.11.2016 të Këshillit të Ministrave “Për strukturën, kriteret e përzgjedhjes dhe marrëdhëniet e punës së punonjësve të njësisë përgjegjëse në autoritetet publike në zbatim të ligjit nr. 60/2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”,

URDHËROJ:

1. Përbërjen e njësisë përgjegjëse të përhershme për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të jetë me një punonjës, si më poshtë vijon:
 - Znj. Alma Zili - Përgjegjës, Sektori i Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse;
 - Znj. Zonje Shelqizi - Specialist (Burime Njerëzore), në Sektorin e Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse.
2. Njësia Përgjegjëse ndjek në vazhdimësi sinjalizimin e një veprimi ose praktike të dyshuar korrupsioni si dhe mbrojtjen e sinjalizuesve nga hakmarrja në veprimtarinë e saj, duke mbajtur kontakte të vazhdueshme me ILDKPKI-në.

3. Ngarkohet njësi përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve për zbatimin e këtij urdhri dhe Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, për njoftimin e këtij Urdhri.
4. Urdhri nr. 118, datë 18.11.2023, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, shfuqizohet.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

